




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4289/15, për zyrtarin e lartë z. Shpetim Zhegrova, Kryesues i Kuvendit në Komunën e Vushtrrisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të mundshëm të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4289/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Shpetim Zhegrova, Kryesues i Kuvendit në Komunën e Vushtrrisë.

Gjatë kontrollit për identifikimin e rasteve të mundshme të konfliktit të interesit është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznese privat dhe figuron si person i autorizuar në këtë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.11.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Shpetim Zhegrova, ka kontaktuar në zyrat e AKK-së, ku është njoftuar me gjendjen dhe me obligimet që ka ai si zyrtar i lartë për të parandaluar konfliktin e interesit.

Zyrtari i lartë z. Shpetim Zhegrova, Kryesues i Kuvendit në Komunën së Vushtrrisë, është pajtuar me gjendjen por është arsyetuar se nuk ka pas njohuri lidhur me situatën e konfliktit të interesit por brenda afatit ligjor do të bëj ndryshimet dhe do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Me datën 24.12.2015, kemi pranuar dokumentet e dërguara nga zyrtari te lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Shpetim Zhegrova, nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin “ N.T.P GALAXY ” me numër biznesi 70587556 .

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Shpetim Zhegrova, Kryesues i Kuvendit në Komunën e Vushtrrisë, duke bër ndryshimet në biznesin privat dhe duke hequr dorë nga ushtrimi i pozitës se personit të autorizuar në biznesin e tij janë krijuar rrethana të reja dhe konstatojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik dhe vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

